REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 971/20
Datë/Datum. 19.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **652-20-6018-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me aparat Biokimik full automatik**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Ntsh"AtomMed"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr: Uran Tinova p.n

(Adresa)

Ferizaj — ***70000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049530552 — ***N/A***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Donika Prekadini
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

atommed@hotmail.com
(Adresa elektronike)

18.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

N.T.SH. AtomMed medical solution FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*
(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës.

- Njoftimi për kontratë me dt: 06.10.2020 përmes prokurimit elektronik
- Hapja e tenderëve dt. 27.10.2020
- Letrën Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ultë dt. 29.10.2020.
- Përgjigje në kërkesën dt. 30.10.2020
- Vendimi i AK për dhënie dt. 03.11.2020
- Kërkesë për ri-shqyrtim në AK dt. 06.11.2020
- Vendimi i AK-së për refuzim më dt. 10.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			Jo	X

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☐			**Jo**	☐

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 23 i LPP-së
Neni 59, i LPP-së
Neni 60, i LPP-së,
Neni 61, i LPP-së
Neni 4 i RRUOPP-së
Neni 41 i RRUOPP-së

Neni 7 i Rregullave për parashtrimin e ankesave.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar. Kërkojmë nga ana juaj, që të ndërmerrni hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm që Komuna e Kaçanikut mos të bëjë diskriminime dhe shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit publik dhe të sillet konform këtyre dispozitave, ngase ne vazhdimisht për këtë autoritet kontraktues jemi të eliminiuar që në fazat e para te tenderimit por edhe në fazën e vlerësimit. Komuna e Kaçanikut për aktivitetin në fjalë, me daten 03.11.2020, per kete aktivitet te prokurimit ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, duke na eliminuar padrejtësisht, nga ky aktivitet për shkak të proceseve jo fer të zhvilluara që nga shpallja e këtij aktivitetit të prokurimit, që më pastaj ka rezultuar që vlerësimi i tenderëve të bëhet në kundështim me dispozitat ligjore për prokurim publik.

Ne me dt. 06.11.2020, kemi paraqitur kërkesën për ri-shqyrtim në AK-Komunën e Kaçanikut. Por, Komuna me vendim të dt. 10.11.2020, e hedhë poshtë kërkesën tonë si të pabazuar. Vendim ky i cili **nuk** është nxjerrur nga Zyrtari përgjegjës i Prokurimit, por nga Kryetari i Komunës. Kjo lenë të kuptohet se zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk është duke i kryer detyrat dhe përgjegjësit që i takojnë me Ligjin e Prokurimit Publik, konkretisht me **nenin 23 të LPP-së**. Kjo, po ashtu, është në kundërshtim edhe me *Rregullat për parashtim të ankesave, konkretisht neni 7*, ku të gjitha përgjegjësit i ka Zyrtari përgjegjës i prokurimit, dhe citon: "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim nga ***Zyrtari Përgjegjës i prokurimit***, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë."

Në **nenin 4.4 të RRUOPP-së**, Administrimi i Përgjithshëm i Procedurave të Prokurimit, shkruhet se të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:
Konkurrenca, Efikasiteti & Efektiviteti, Drejtësia/Mos-diskriminimi, Objektivitet / Integritet/ Sinqeritet, Transparenca, Llogaridhënie, Profesionalizëm. Ne ju garantojmë se asnjëri nga këto parime nuk është respektuar nga Komuna e Kaçanikut gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Pretendimi ankimor 1.
Komuna e Kaçanikut ka vepruar në kundështim me dispozitat ligjore të prokurimit publik, duke rekomanduar OE të papërgjegjshëm, ngase në bazë të katalogut të ofruar ky OE nuk i ka përmbushur specifikimet teknike të detyrueshme të vendosura Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit,:

Sistemet e funksionit :Gjenerale :
(mungon)
Principi punes : Kolorimetri , Turbidimetri ,

SPECIFIKIMET MINIMALE APO EKUIVALENTE Monitor TFT shumëngjyrësh, me ngjyra dhe 12,1 "
Mungojnë:

Shfaq njëkohësisht të paktën 10 parametra, 13 lloje të analizës së aritmisë
15 lloje të llogaritjeve të dozës së ilaçeve
1000 orë të dhëna për trendin dhe grafikët e trendit, 48 orë rishikim të plotë të formës së valës
Ruajtja e të dhënave për ndërprerjen e energjisë
Kapacitet i lartë i ruajtjes së informacionit
Dizajn i dukshëm nga i gjithë drejtimi; 3 nivele të alarmit auditiv, vizual dhe audio; drita alarmi të dyfishta për alarm fiziologjik dhe teknik

Specifikime MINIMLAE TEKNIKE OSE EKUIVALENTE EKG

Modaliteti i plumbit: 5 leads (R, L, F, N, C ose RA, LA, LL, RL, V) **(mungon)**

SPECIFIKIMET MINIMALE APO EKUIVALENTE Centrifuge 12 pozicione
Mungojnë:

- Mundesi hapje emergjente
- Sistemi ftohjes permes ventilimit te airit , duke reduktuar temperaturen e rotorit
- Alarm automatic pasi rotori te perfundoj punen dhe te hapet

Te dhenat specifike:
Mungojnë:

- Max RCF 2740xg
- Kohe e programueshme : 0-99 m,59s
- Niveli I zhurmes gjat punes <56 dB

Andaj, Komuna e Kaçanikut ka **bërë shkelje të nenit 59.4 të LPP-së**, sepse Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Po ashtu, edhe **shkelje të nenit 41 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, konkretisht paragrafi 41.3**, cili paraqet parimet kryesore të vlerësimit të tenderëve sipas LPP-së, dhe njëri ndër ato parime është në ***pikën 3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.***

Pretendimi ankimor 2.
Këto gabime të Komunës së Kaçanikut kanë qenë edhe rezultat i specifikimit teknik i cili ka qenë jo profesional dhe jemi munduar që përmes veprimeve ligjore në fazen e tenderimit t'ju sqarojmë këtë, por për Komunën ka qenë e kot. Përshkak se me vlerësu ofertën konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 59 të LPP-së dhe nenit 41 të RRUOPP, komisioni i vlerësimit duhet ta ketë një specifikim profesional para vete, e jo si në këtë rast, ku ne specifikimin teknik të detyrueshëm ka pasur aparat i cili ka munguar në përshkrim të çmimeve, bëhet fjalë për:
Autoanalizator per D-Dimer , Hba1C , Analizatori te ofrohet me 2 vite garancion , te posedoje serivser te Certifikuar nga kompania gjegjese .
Automatikisht, në fazën e vlerësimit komisioni i vlerësimit ka rënë ndesh me dispoziten ligjore të **RRUOPP, nenin 41.5. pika b.**

"Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:
b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;"

Njëra prej arsyes se çmimi jonë ka qenë edhe më i ulët se të tjerët është ky fakt.

Pretendimi ankimor 3.

Ne me dt.29.10.2020, nga Komuna e Kaçanikut kemi pranuar Letrën Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ultë, duke kërkuar sqarime rreth ofertës tonë. Ne menjëherë me dt. 30.10.2020, ju kemi ofruar Komunës të gjitha informacionet dhe arsyet kryesore dhe mjaftë të bazuara se pse oferta jonë ka këtë çmim, dhe jemi munduar tju bëjmë me dije se ne jemi Distributor te Autorizuar per Kosove nga shume Kompani te brendeve nderkombtare sa i perket Paisjeve Mjeksore, kjo na e mundeson ofertimin me qmime te tregut per te cilat munden Komunës me ju dukë jo-normalisht te ulta.
Po ashtu jemi deklaruar se pranojmë edhe rritje të vlerës së sigurimit të ekzekutimit vetëm e vetëm me ju garantu Komunës se ne qëndrojmë prapa çmimeve tona dhe furnizimin do ta bëjmë konform afateve kontraktuale.
Ndërsa përgjigja e Komunës për këtë ishte se ne nuk ju jemi përgjigjur konform nenit 61 të LPP-së.
Komuna e Kaçanikut me qëllim dhe me vetëdije të plotë është duke na dëmtuar neve dhe duke na diskriminuar, duke mos i marrë për bazë informacionet dhe shpjegimet shtesë që i kemi japur vazhdimisht dhe gjatë tërë kohës, prej shpalljes së këtij tenderi. Sepse edhe me nenin 61, të LPP-së, paragrafi 3, citohet: *"Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë."*
Me këto diskriminime është duke i kushtuar edhe buxhetit të komunës gjegjësishtë taksapaguesëve të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni **me nenin 59 të LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i **<u>përgjegjshëm</u>** me çmim më të ulët sipas **neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**. E që në këtë rast OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm.

Të gjitha aktet legjislative primare dhe sekondare të Prokurimit Publik, e ndalojnë përgatitjen e Dosjes së Tenderit që në një mënyrë favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial. Kjo është e cekur edhe ne **Nenin 7 të LPP-së**, Është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu, Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të

operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Lidhur me të gjitha këto parregullësi, ju si autoritet kontraktues, përveç shkeljeve të lartëpërmendurs, në mënyrë direkte bëni edhe shkelje tjera të këtyre dispozitave të prokurimit publik, e të cilat janë:

Neni 1 i LPP-së, e obligon AK-në që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 i LPP-së. AK-në e obligon që të siguroni që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Dhe jo të veprohet edhe më tutje me këto kërkesa dhe në këtë mënyrë, ku ju, si autoritet kontraktues rrezikoni seriozisht të dëmtoni buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për OE të caktuar, atëherë mundësia është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së.

Neni 4.1 i RRUOPP-së, citon "AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik."

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të merr::

VENDIM

APROVOHET: Ankesa e OE Ntsh "AtomMed" si e bazuar

ANULOHET: vendimi i AK-së për këtë aktivitet i prokurimit, dhe përshkak të gabimeve të cilat tani janë të paripërueshme në këtë fazë, pastaj, Komuna e Kaçanikut ti bëjë përmirësimet e nevojshme dhe konform dispozitave ligjore dhe ta ri-shpall këtë aktivitet të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Neve si Operator ekonomik na janë bërë dëme materiale dhe jomateriale. Për përgatitjen rreth këtij aktiviteti, shpenzime të letrës, stafit, si dhe shpenzime në përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, diku në vlerë rreth 3,000.00 €.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP. Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*